



SHËRBIMI I PROVËS



Qendra e Shërbimeve dhe
Praktikave Ligjore të Integruara

Nr. 622, datë 05/04 /2024

Nr. 9, datë 02/04 /2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, përfaqësuar nga **Z. Ermal PACAJ**, Drejtor i Përgjithshëm, në bazë të tagrave që i jep Ligji nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës”, në VKM nr. 421 datë 08.07.2021 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës” dhe Ligji nr. 79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”.

Dhe

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, përfaqësuar nga **Znj. Anjeza Puka**, drejtore ekzekutive, me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Ap. 24 Tiranë, që më poshtë do të quhet QSHPLI, në bazë të tagrave që i jep ligji nr.8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse, i ndryshuar me Ligjin nr. 9814 datë 04.10.2007 dhe Ligjin nr. 92/2013 datë 28.02.2013.

PALËT deklarojnë që me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Palëve dhe dhe angazhimit të ndërsjellë për të siguruar zbatimin e dënimeve alternative përmes ofrimit të shërbimeve ligjore, psiko-sociale dhe edukative.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është ofrimi i shërbimeve ligjore, psiko-sociale, ndërmjetësuese, nxitjen e punësimit dhe kualifikimit profesional për të dënuarin, përfshirjen e tyre në programe të ndryshme ri-integruese, me qëllim kapërcimin e vështirësive që të dënuarit kanë sa i përket integrimit social dhe përmbushjen e nevojave me këtë qëllim. Target grup prioritar do të jenë të miturit dhe të rinjtë nga kategoritë vulnerabël. Gjithashtu, kjo marrëveshje ka objekt edhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta të natyrës promovuese, ndërgjegjësuere, dhe trajnuese në fushën e drejtësisë me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për dënimet alternative dhe po ashtu rritjen e kapaciteteve të profesionistëve.

Neni 3

Baza Ligjore

Baza ligjore e kësaj Marrëveshje janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Ligji nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, Ligji nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës”, VKM nr. 421 datë 08.07.2021 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës” dhe Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”.

Neni 4

Parimet e bashkëpunimit

Nëpërmjet kësaj marrëveshje bashkëpunimi, Palët nënshkruese, në respektim të nenit 4, 5 dhe 7 të Ligjit “Për organizatat jofitimprurëse“, sigurojnë se gjatë veprimtarisë së tyre do të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me synim zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe të dëmtuarit, si dhe të inkurajimit të riintegritimit social të të dënuarit, nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe të ndërveprimit social.

Neni 5

Detyrimet e QSHPLI-së

Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara përmbush detyrimet e mëposhtme:

- b. Kryen takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës për të diskutuar rreth veprimtarive të QSHPLI dhe/ose veprimtarive të përbashkëta që janë objekt i kësaj marrëveshje. Gjithashtu, mbi baza projektesh specifike, QSHPLI mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës;
- c. Kontakton të dënuarit pasi i është vënë në dispozicion letër referenca e rastit nga Shërbimi i Provës;
- d. Ofron shërbime juridike parësore dhe dytësore pa pagesë për të dënuarit e referuar nga Shërbimi i Provës;
- e. Ofron shërbimin psikologjik pa pagesë për të dënuarit e referuar nga Shërbimi i Provës;
- f. Ofron falas mbi bazë projekti mundësinë e përfshirjes së të dënuarve në programe edukative, trajnuese, kualifikuese dhe të punësimit sipas nevojave specifike të të dënuarve të referuar nga Shërbimi i Provës;
- g. Zbaton planin e trajtimit sipas letër referencës për çdo rast të referuar;
- h. Informon vazhdimisht përmes raporteve Shërbimin e Provës për progresin e veprimtarisë me të dënuarit;
- i. Ndan paraprakisht për konsultim me Shërbimin e Provës materialet informuese që prodhon me fokus ndërgjegjësimin e të dënuarve mbi dënimet alternative, por edhe më gjerë mbi rregullat dhe procedurat për të përfutur nga ky legjislacion, si dhe kushtet ligjore që duhet të respektojnë pasi kanë përfutur dënimin alternativ;
- j. Siguron që çdo program që ndërmerr, të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme dhe të ndiqet nga një staf i përgatitur që ofron shërbime cilësore;
- k. Përfshin në programe kontaktet me familjen, kur i dënuari është i mitur;
- l. Informon Shërbimin e Provës kur çmon se për arsye të ndryshme programi i parashikuar ka patur sfida apo pamundësi për tu zbatuar;
- m. I pergjigjet me shkrim çdo kërkesë të Shërbimit të Provës për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi;
- n. Merr pjesë në takime, diskutime dhe konsultime të përbashkëta me Shërbimin e Provës.

Neni 6

Detyrimet e Shërbimit të Provës

Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), Shërbimi i Provës përmbush detyrimet e mëposhtme;

- a. Kryen konsultime me QSHPLI lidhur me projekte të mundshme me fokus në veprimtarinë objekt të kësaj marrëveshjeje;
- b. Harton një Letër Reference për të dënuarin dhe komunikon me QSHPLI për të zbatuar një program të caktuar specifik për të dënuarin;
- c. I dërgon QSHPLI Letër Referencën jo më vonë se **3 ditë** pas vlerësimit të nevojës për referim;
- d. Përfshin QSHPLI në programin individual që harton dhe zbaton për të dënuarit;
- e. Informon të dënuarin për bashkëpunimin që do të ketë me QSHPLI dhe mundësitë që i ofrohen për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme dhe shërbimet në kuadër të këtij plani trajtimi;

Për çdo problem gjatë zbatimit të marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes.

Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa do lidhen me këtë akt-marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Neni 11 **Dispozita të fundit**

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Për

DREJTORINË E PËRGJITHSHME

TË

SHËRBIMIT TË PROVËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ermal PACAJ



Për

QENDRËN E SHËRBIMEVE

DHE PRAKTIKAVE LIGJORE

TË INTEGRUARA

DREJTOR EKZEKUTIV

Anjeza PUKA

